



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria e Kosovës - Vlada Republika - Government of Kosovo MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË-MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE-MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY			
Mjesta Orig. Org. Jedin. Org. Unit	01	No. Prot. Br. Prot. Prot. No.	379
Nr. i Tërbës Broj stranice Ref. pag#	7	Data Datum Date	13.11.09
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Në bazë të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 6 paragrafi 6.8 nënparagrafi (ii) të Ligjit “Për Metrologji” Nr. 02/L-34, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 2009/22
PËR AUTORIZIMIN E SUBJEKTEVE PËR VERIFIKIM, SHQYRTIMIN E
KONFORMITETIT DHE MATJEVE ZYRTARE TË MJETEVE MATËSE TË
RRJEDHJES SË LËNGJEVE ME PËRJASHTIM TË UJIT

Neni 1
Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë subjektet me qëllim të marrjes së autorizimit për verifikimin, shqyrtimin e konformitetit dhe matjeve zyrtare të mjeteve matëse të rrjedhjes së lëngjeve me përjashtim të ujit (në vazhdim të tekstit mjetet matëse të rrjedhjes).

Neni 2

Subjektet të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë Udhëzim administrativ kryejnë testimin e konformitetit të mjeteve matëse të rrjedhjes në përputhje me kërkesat tekniko-metrologjike (në vazhdim të tekstit-testimin), verifikimin e tyre si dhe matjet zyrtare.

Neni 3

1. Në kuptim të këtij Udhëzimi Administrativ me verifikim të mjeteve matëse të rrjedhjes ligjërish të kontrollura të cilat përdoren nënkuptojmë:

- 1.1. Kontrollimin,verifikimin e mjetit matës si dhe vulosjen e tij;
- 1.2. Testimin e mjetit matës të rrjedhjes, përkatësisht vërtetimin e vetive të mjeteve matëse si dhe
- 1.3. Plotësimin e raportit për testimin e mjetit matës të rrjedhjes.

Neni 4

Kushtet dhe kërkesat tekniko - metrologjike që duhet plotësuar nga subjektet për marrjen e autorizimit

1. Subjekti i autorizuar duhet t'i plotësoj kushtet dhe kërkesat tekniko-metrologjike të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ dhe dispozita tjera ligjore që e rregullojnë këtë fushë, siq janë:

- 1.1. Të posedoj etalonët përkatës, pajisje teknike, hapësirë dhe personel të nevojshëm profesional për kryerjen e aktiviteteve për të cilat kërkohet autorizimi;
- 1.2. Të siguroj krahasueshmërinë e pajisjeve/etalonëve matëse të cilat i përdorë;
- 1.3. Të mos merret me prodhimin, importimin, shitjen apo riparimin e instrumenteve matëse nga fushat e autorizimit.

Neni 5

1. Për testimin dhe verifikimin e mjeteve matëse për rrjedhje, subjekti i autorizuar duhet t'i posedojnë pajisjet/etalonët e nevojshëm me specifika si më poshtë:

1.1 Për verifikimin e sistemeve matëse në autobotet për karburante dhe pajisjet për verifikimin e sistemeve matëse në vendet për mbushjen e autoboteve si dhe për botet hekurudhore janë të nevojshme këto pajisje:

1.1.1. Së paku njëra nga këto pajisje:

- 1.1.1.1. enët matëse etalon me vëllim minimal i cili mundëson testimin e rrjedhjes 60 sekondëshe për rrjedhjen maksimale të sistemit matës me pasiguri maksimale matëse $\pm 0,05\%$;
- 1.1.1.2. nyjet gypore etalon (prover) ose gypi etalon me piston (compact prover) me pasiguri maksimale matëse $\pm 0,03\%$;
- 1.1.1.3. mjeti matës krahasues me enën vëllimi minimal i së cilës mundëson testimin 60 sekondësh për rrjedhje maksimale të sistemit matës me pasiguri maksimale matëse $\pm 0,1\%$.

1.1.2. Termometri, ndarja minimale e të cilit nuk duhet të jetë më e madhe se 0.1°C ;

1.1.3. Kronometrin.

1.2. Për verifikimin e mjetit matës të rrjedhjes vëllimore të cilat nuk gjenden në sistemin matës janë të nevojshme këto pajisje:

1.2.1. Së paku njëra nga këto pajisje:

1.2.1.1. ena matëse etalon me vëllim minimal i cili mundëson testimin e rrjedhjes 60 sekondëshe për rrjedhjen maksimale të sistemit matës me pasiguri maksimale matëse $\pm 0,05\%$;

1.2.1.2. mjeti matës krahasues me enën me vëllim minimal e cila mundëson testimin e rrjedhjes 60 sekondëshe për rrjedhjen maksimale të sistemit matës me pasiguri maksimale matëse $\pm 0,1\%$.

1.2.2. sistemi mbyllës i përshtatshëm me rregullator dhe mjetin matës të rrjedhjes, klasa e saktësisë 0.5 dhe me mundësi rregullimi në kufijtë e rrjedhjes prej Q_{min} deri Q_{max} të mjetit matës i cili kontrollohet;

1.2.3. Termometri, ndarja minimale e të cilit nuk duhet të jetë më e madhe se 0.1°C ;

1.2.4. Kronometri.

1.3. Për verifikimin e sistemeve matëse në autobote për qumësht dhe medimeve tjera në industrinë ushqimore janë të nevojshme këto pajisje:

1.3.1. Ena matëse etalon me vëllim minimal e cila mundëson testimin e rrjedhjes 60 sekondëshe për rrjedhjen maksimale të sistemit matës me pasiguri maksimale matëse $\pm 0,05\%$;

1.3.2. Termometri, ndarja minimale e të cilit nuk duhet të jetë më e madhe se 0.1°C ;

1.3.3. Kronometri.

1.4. Për verifikimin e sistemeve matëse në autobotet ose sistemeve matëse stabile për gazet e lëngshme janë të nevojshme këto pajisje:

1.4.1. Ena matëse etalon me vëllim minimal 1000 litra me pasiguri maksimale matëse $\pm 0,1\%$;

1.4.2. Termometri ndarja e minimale e të cilit nuk duhet të jetë më e madhe se 0.1°C ;

1.4.3. Kronometrin.

1.5. Për verifikimin e distributorëve për zbrazjen respektivisht mbushjen e mjetit motorik me karburant janë të nevojshme këto pajisje:

1.5.1. Enët matëse etalon prej 20 litra, 50 litra, 100 litra, dhe 200 litra për rrjedhje deri në 200 l/min me pasiguri matëse maksimale $\pm 0,05\%$;

1.5.2. Termometri, ndarja e minimale e të cilit nuk duhet të jetë më e madhe se 0.1°C ;

1.5.3. Kronometri.

1.6. Për verifikimin e distributorëve për zbrazjen respektivisht mbushjen e mjetit motorik me karburant, për gazet e lëngshme janë të nevojshme këto pajisje:

1.6.1. Enët matëse etalon prej 20 litra, me pasiguri matëse maksimale $\pm 0,1\%$;

1.6.2. Termometri, ndarja e minimale e të cilit nuk duhet të jetë më e madhe se 0.1°C ;

1.6.3. Kronometri.

Neni 6

1. Subjekti i autorizuar duhet të udhëheq evidencën mbi testimet dhe verifikimet e kryera.
2. Subjekti i autorizuar është i obliguar të ruaj dokumentacionin nga testimet dhe verifikimet në një kopje elektronike dhe një kopje fizike, në afat jo më pak se 3 (tre) vite.
3. Subjekti i autorizuar në vazhdimësi duhet të ketë qasje në internet dhe në bazën e të dhënave të Departamentit të Metrologjisë së Kosovës.

Neni 7

1. Për testimin dhe verifikimin e mjeteve matëse të rrjedhjes, subjekti i autorizuar duhet të posedojë hapësirë të mjaftueshme të punës që i plotëson kushtet si më poshtë:

- 1.1. të jetë e pastër, e thatë dhe me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve, si edhe për testim dhe verifikim të papengueshëm të mjeteve matëse të rrjedhjes;
- 1.2. të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit;
- 1.3. në hapësira dhe në rrethinë të mos ketë burim të vibrimit që do të ndikonte në saktësi të matjeve;
- 1.4. të ketë ndriçim të mjaftueshëm natyror dhe artificial;
- 1.5. të ketë termometër për matjen e temperaturës së ajrit në diapazon 0°C deri 35°C me ndarje prej 0.5°C , të kalibruar;
- 1.6. të ketë instrumentin për matjen e lagështisë, të kalibruar.

Neni 8

Në hapësirat punuese të destinuara për testim dhe verifikim të instrumenteve matëse duhet të vendosen pajisjet për këtë qëllim dhe kjo hapësirë nuk mund të shfrytëzohet për asnjë aktivitet tjetër.

Neni 9

Burimet e nxehtësisë në hapësirat punuese për testim dhe verifikim duhet të jenë të larguara nga pajisjet, përkatësisht nga vendi ku realizohet testimi në distancë së paku 1.5 m si dhe duhet të krijojnë mundësinë e ngrohjes lineare të të gjithë hapësirës.

Neni 10

1. Subjekti i autorizuar duhet të ketë të punësuar personin përgjegjës profesionalisht të aftësuar për kryerjen e detyrave të metrologjisë për fushën për të cilën autorizohet.
2. Personi përgjegjës nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të posedoj dëshmi për punët testuese të instrumenteve matëse dhe/ose të posedoj certifikatë të trajnimit nga fusha e autorizimit, si dhe të ketë dëshmi mbi provimin e dhënë profesional.

3. Nëse personi përgjegjës sikurse në paragrafin 2 të këtij neni nuk posedon dëshminë mbi provimin e dhënë profesional, këtë duhet ta bëjë më së voni 6 muaj nga fillimi i mbajtjes së provimit profesional i cili organizohet nga MTI.

Neni 11

1. Subjekti i autorizuar duhet të posedoj dokumentet e nevojshme:

- 1.1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- 1.2. Dëshminë mbi përgatitjen profesionale të personit përgjegjës për kryerjen e detyrave të metrologjisë për fushën e caktuar të autorizimit;
- 1.3. Fotokopjen e noterizuar të lejes së njoftimit të personit përgjegjës apo dëshminë mbi rregullimin e vendqëndrimit në Kosovë, në rast se ai nuk është shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.4. Kontratën e punës me personin përgjegjës nga lëmia e metrologjisë, me validitet për së paku 3 vite;
- 1.5. Dokumentet e testimit/verifikimit të instrumenteve matëse nga fusha e autorizimit, të aprovuara nga DMK;
- 1.6. Udhëzuesit e përdorimit, ruajtjes dhe përcjelljes së gjendjes së pajisjeve për testim dhe verifikim nga prodhuesi;
- 1.7. Formularët e kërkesave, raporteve të testimit, certifikatave për verifikim, të aprovuara nga DMK;
- 1.8. Regjistrin e pajisjeve për testim dhe verifikim, me të dhëna teknike dhe me certifikatat e kalibrimit për secilën pajisje/etalon ose certifikatat e verifikimit për pajisjet plotësuese, respektivisht certifikatat e testimit për materialet referente;
- 1.9. Dëshminë se personi përgjegjës nuk është dënuar me burgim prej së paku 3 muaj, për vepër penale të kryer me dashje;
- 1.10. Dëshminë se subjekti nuk është në procedurë të falimentimit.

Neni 12

Verifikimi i instrumenteve dhe pajisjeve matëse ligjore

1. Subjekti i autorizuar teston dhe verifikon instrumentet matëse ligjore të cilat janë në shfrytëzim dhe përdorim nga subjektet afariste në tregun e Republikës së Kosovës.
2. Verifikimi i instrumenteve matëse ligjore mund të jetë fillestar, i rregullt apo i jashtëzakonshëm- (në rast të riparimit të mjetit matës).
3. Subjekti i autorizuar mund të bëjë verifikimin edhe kur mjete matës për rrjedhje është i shënuar me shenjë verifikuese.
4. Procedurat e testimit dhe verifikimit të llojeve të caktuara të instrumenteve matëse përcaktohen me Udhëzime Administrative të veçanta, apo me rregullore teknike të pranuar që specifikojnë kërkesat tekniko-metrologjike.

Neni 13

Shenjat e verifikimit

Lloji, forma dhe mënyra e vendosjes së shenjave të vërtetimit të cilat përdoren për verifikimin e mjeteve matëse ligjore, si edhe forma dhe përmbajtja e vërtetimit/certifikatës së verifikimit është e përcaktuar me udhëzim administrativ të veçantë.

Neni 14

Detyrimet e subjektit të autorizuar

1. Subjekti i autorizuar, përveç kërkesave të parapara me dispozita të ligjit për metrologji dhe me këtë udhëzim administrativ duhet:

- 1.1. Të ushtroj veprimtarinë nga autorizimi në mënyrë profesionale dhe të vazhdueshme në pajtim me rregullat dhe vendimin për autorizim;
- 1.2. Të njoftoj DMK-në në afat prej 3 (tre) ditësh për çfarëdo ndryshimi të kushteve të autorizimit;
- 1.3. Të paraqesë në DMK regjistrin e pajisjeve/etalonëve bashkë me certifikatat e kalibrimit/verifikimit së paku një herë në vit, ose kur kjo i kërkohet gjatë mbikëqyrjes nga zyrtarët përgjegjës të DMK-së;
- 1.4. Të paraqes raportin e punës për çdo 3 muaj në DMK si dhe raportin e përgjithshëm vjetor jo më vonë se 31 janari i vitit vijues;
- 1.5. Të mundësojnë kryerjen e mbikëqyrjes metrologjike sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2. Subjektit të autorizuar i cili vepron në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kundër vendimit për autorizim i shfuqizohet vendimi i autorizimit, si dhe i njëjti nuk mund të parashtroj kërkesë të re për autorizim në afatin kohor 5 (pesë) vjeçar nga dita e anulimit.

Neni 15

DMK është përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e subjekteve të autorizuara sipas dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë.

Neni 16

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ, subjektet e interesuara mund të aplikojnë për marrjen e autorizimit për kryerjen e punëve për këtë fushë.
2. Subjektit të autorizuar i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë udhëzim administrativ i lëshohet autorizimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh nga dita e dhënies së autorizimit.
3. Vazhdimi, ripërtëritja e autorizimit kryhet në procedurë të njëjtë sikurse në rastin e dhënies së autorizimit.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohen të gjitha aktet nënligjore juridike të cilat e kanë rregulluar këtë fushë.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ministri i MTI-së.

Prishtinë 13.11.2009



Ministri i Tregtisë dhe Industrisë
Lutfi Zharku